

20
23



BULETINI METROLOGJIK

NR.2 - 2023

PËRMBAJTJA

Pasqyra e lëndës:

1. Vizioni dhe Misioni	3
2. Aktivitet mbi Produktet elektrike dhe makineritë.....	4
3. Programi global i cilësisë dhe standardeve (GQSP).....	5
4. Takimi i katërt vjetor i komitetit teknik të WELMEC.....	7
5. Takimi vjetor i komitetit teknik të cilësisë, EURAMET.....	7
6. Llogaritja e pasigurisë në matje në analizat kimike”, trajnim online.....	8
7. Aktivitet trajnues.....	8
8. Ndërgjegjësim mbi infrastrukturën e cilësisë, Sarandë.....	9
9. Aktivitete promovuese.....	9
10. Dita Botërore e Metrologjisë.....	10
11. Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë dhuron gjak.....	11
12. Marrëveshje bashkëpunimi.....	11
13. Broshura & postera informues mbi veprimtarinë e DPM- së.....	12
14. Subjektet e autorizuara për kryerjen e verifikimeve të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar.....	13



1.Vizioni

Zhvillimi i infrastrukturës bazë metrologjike në zonat prioritare për ekonominë dhe inovacionin në industri për të ruajtur aftësinë dhe për të siguruar gjurmueshmërinë metrologjike të matjeve. Plotësimi i kërkesave të Marrëveshjes së Njohjes Reciproke (CIPM MRA) për të garantuar gjurmueshmërinë dhe njohjen zyrtare të matjeve të proceseve të prodhimit në nivelin më të lartë të cilësisë si mekanizëm për të hequr barrierat teknike në tregti për prodhuesit dhe eksportuesit vendas.



Misioni

Rregullimi i sistemit të njësisë së matjes, standardeve të matjes, bazat për të siguruar gjurmueshmërinë e matjes, kontrollin metrologjik ligjor të instrumenteve matëse dhe rregullat për organizimin e funksionimin e sistemit kombëtar metrologjik në Republikën e Shqipërisë.

2. AKTIVITET MBI PRODUKTET ELEKTRIKE DHE MAKINERITË

Në kuadër të komponentit “EU4 Biznesi: Nxitja e tregut të përbashkët rajonal përmes infrastrukturës cilësore dhe e-tregtisë”, bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe BMZ dhe zbatuar nga GIZ (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit), nëpërmjet projektit “Fondi i Hapur Rajonal për Tregtinë e Jashtme”, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë 8 mujorit të vitit 2023 ka qenë pjesë e një sërë aktivitetesh të realizuara për produktet elektrike të mbuluara nga direktivat LVD dhe EMC dhe produktet mekanike.

Fillimisht bashkëpunimi nisi me dhënie përgjigjesh nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e situatës aktuale në lidhje me kapacitetet dhe aftësitë e të gjithë aktorëve e sistemeve të infrastrukturës së cilësisë (QI) në palët e CEFTA-s, për këto produkte.

Me pas u zhvilluan dy aktivitete, përkatësisht në Budva të Malit të Zi në datë 29 - 30 Mars 2023 për produktet elektrike dhe në Durrës, Shqipëri në datë 06 - 07 Qershor 2023 për produktet mekanike me përfaqësues të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku gjatë takimeve u diskutuan gjetjet kryesore të vlerësimit të situatës aktuale, gadishmërinë e institucioneve të infrastrukturës të cilësisë për të zhvilluar apo ndihmuar këto fusha (metrologji, standardizim, akreditim, mbikëqyrje tregu) në ekonominë e CEFTA si dhe u prezantuan koncepte të funksionimit të një rrjeti rajonal të këtyre institucioneve.



Pas këtyre aktiviteteve, përpara implementimit të masave të finalizuara për produktet e sipërpërmendura Ministria e Financave dhe Ekonomisë organizoi në datë 29 Qershor 2023, “Takimin kombëtar me institucionet e infrastrukturës të cilësisë dhe operatorët ekonomike në sektorin e produkteve elektrike dhe makinerive”. Gjatë këtij takimi u prezantuan gjetjet kryesore dhe situata aktuale për produktet elektrike dhe mekanike në Shqipëri.




Sisteme shumë të zhvilluara të Infrastrukturës së Cilësisë janë një parakusht për lëvizjen e lirë të mallrave industriale dhe për rritjen e tregtisë brenda tregjeve të CEFTA, si rrjedhojë projekti do vazhdojë të organizojë aktivitete në nivel institucionesh për të implementuar masat e vendosura gjatë takimeve të përbashkëta.

3. PROGRAMI GLOBAL I CILËSISË DHE STANDARDEVE (GQSP)

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë është pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania me fokus "Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës për bimët medicinale, aromatike dhe fruta perimet" e cila implementohet nga UNIDO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri (SECO).

Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit janë zhvilluar disa aktivitete dhe mbledhje, ndër të cilat përmendim:

Mbledhjen e Komitetit Drejtues i cili u mbajt në ambientet e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ku morën pjesë Zëvendës Ambasadori i Zvicrës, Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Kryetari i KASH, Menaxheri i Projektit GQSP, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ekipi i GQSP si dhe vëzhgues nga drejtoritë e Standardizimit, Metrologjisë dhe Akreditimit të cilët diskutuan gjetjet dhe rekomandimet e fazës fillestare të GQSP. Kjo mbledhje startoi fazën e inicimit të programit në Shqipëri.



Në vazhdim gjatë muajit Shkurt u realizua workshop-i i fokusuar në ndërgjegjësimin, sfidat dhe nevojat mbi çështjet kryesore që lidhen me bimët medicinale dhe aromatike dhe sektorët e ushqimit dhe perimeve në përmbushjen e standardeve të cilësisë dhe kërkesave të tregut të huaj. Ky aktivitet mblodhi së bashku politikëbërës, partnerë dhe përfaqësues të sektorëve për të dhënë kontribut në analizën e zinxhirit të vlerës, e cila do të mundësojë më pas zhvillimin e bashkëpunimit për përmirësimin e sistemit të infrastrukturës së cilësisë kombëtare dhe shërbimeve për dy zinxhirët e vlerave në Shqipëri.



Gjithashtu, pjesë e aktiviteteve të projektit ishte edhe takimi bilateral i menaxherit të projektit GQSP me pikën e kontaktit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë në Shqipëri, ku u diskutuan hapat e mëtejshme për vazhdimin e aktiviteteve të DPM-së të cilat në perfundim do synojnë përmirësimin e sistemit të metrologjisë në vend.

Në aspektin teknik, në kuadër të këtij programi, 2 përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë në data 03 - 07 Korrik 2023 në Gjermani, ndoqën trajnimin e Organizatës Botërore të Metrologjisë Ligjore (OIML) për parapaketimet.



4. TAKIMI I KATËRT VJETOR I KOMITETIT TEKNIK TË WELMEC

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë mori pjesë në mbledhjen e katërt vjetore të WELMEC të mbajtur në datat 03 - 05 Maj në Institutin Gjerman të Metrologjisë (PTB). Në takim morën pjesë 55 përfaqësues të vendeve evropiane, përfaqësues të Komisionit Evropian, Organizatës Ndërkombëtare për Metrologjinë Ligjore (OIML), Instituti për Metrologjinë Ligjore (NOBoMet) dhe shoqata European Weighing Industry and its Activities in Metrology (CECIP).

Pjesëmarrësit diskutuan në mënyrë aktive mbi krijimin e rregulloreve dhe direktivave për vlerësimin e konformitetit të instrumenteve që përdoren në Metrologjinë Ligjore si edhe mbi problematikat që shtetet anëtare hasin në lidhje me implementimin e direktivave evropiane për Metrologjinë.



5. TAKIMI VJETOR I KOMITETIT TEKNIK TË CILËSISË, EURAMET

Në datat 28 - 30 Mars, Menaxherja e Cilësisë e DPM-së mori pjesë (online) në takimin vjetor të Komitetit Teknik të Cilësisë i EURAMET-it, i cili u zhvillua në Bern të Zvicrës.


Komiteti Teknik për Cilësinë (TC-Q) është një instrument operacional i EURAMET-it për të ndarë dhe zhvilluar njohuritë mbi standartin ISO/IEC 17025 dhe ISO 17034.

Gjatë takimit u prezantuan Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë (SMC) të zbatuara në Institutet Kombëtare të Metrologjisë me të gjithë komponentët, modifikimet e shfaqura dhe rezultatet e raportimit, të cilat në parim përfaqësojnë një mënyrë të EURAMET-it për të shqyrtuar dhe dhënë besimin për SMC-të të zbatuara.



6. LLOGARITJA E PASIGURISË NË MATJE NË ANALIZAT KIMIKE”, TRAJNIM ONLINE.

Tre specialistë të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale morën pjesë në periudhën 21 Mars - 04 Maj 2023 në trajnimin online me temë: “Llogaritja e pasigurisë në matje në analizat kimike”. Ky trajnim u organizua nga Universiteti i Tartu, Estoni dhe ofroi njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të kryer vlerësimin e pasigurisë për shumicën e analizave kimike rutinë në mjedisin laboratorik. Trajnimi kishte në përmbajtje të tij, pjesë teorike dhe shumë raste shembuj ushtrimesh për realizimin e tij. Në përfundim, pjesmarrësit u pajisën me certifikata trajnimi.



Indirect Measurement

- If the result is obtained as an output quantity by calculations from one or several input quantities then we speak about indirect measurement
- Example: Titration
 - Titrant concentration
 - Volume of sample solution taken for titration
 - Volume of titrant consumed for titration

Measurement model

- Expression that enables calculating the output quantity value (result value) from the input quantity values
- Titration with 1:1 stoichiometry:


$$C_1 V_1 = C_2 V_2$$

Finding u_c

- If the model is: $Y = X_1 + X_2 + \dots + X_n$
- Then: $u_c(y) = \sqrt{u(x_1)^2 + u(x_2)^2 + \dots + u(x_n)^2}$
- All uncertainties have to be converted to standard uncertainties before calculations!

Finding u_c

- If the model is: $Y = \frac{X_1 \cdot X_2}{X_3 \cdot X_4}$
- Then: $u_c(y) = \sqrt{\left(\frac{u(x_1)}{x_1}\right)^2 + \left(\frac{u(x_2)}{x_2}\right)^2 + \left(\frac{u(x_3)}{x_3}\right)^2 + \left(\frac{u(x_4)}{x_4}\right)^2}$
- $\frac{u_c(y)}{y} = \sqrt{\left(\frac{u(x_1)}{x_1}\right)^2 + \left(\frac{u(x_2)}{x_2}\right)^2 + \left(\frac{u(x_3)}{x_3}\right)^2 + \left(\frac{u(x_4)}{x_4}\right)^2}$



7. AKTIVITET TRAJNUES

Në kuadër të planit vjetor të trajnimeve për vitin 2023, Sektori i Sigurimit të Cilësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë organizoi për stafin e laboratoreve trajnimin 2-ditor me temë “Kërkesat e standardit SSH ISO/IEC 17025:2017 dhe zbatimi i tyre në sistemin e menaxhimit të DPM-së”.

Trajnimi kishte si qëllim rifreskimin e njohurive dhe aplikimin korrekt të kërkesave të Standardit ISO/IEC 17025:2017.

Punonjësit e laboratoreve fituan njohuri të reja dhe aftësi praktike për të planifikuar, zbatuar dhe raportuar aktivitetet e laboratorëve sipas kërkesave të këtij standardi dhe dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit të DPM-së. Trajnime të ngjashme do të zhvillohen në vazhdim në ambientet e DPM-së për stafin e laboratorëve dhe punonjësit e saj.



8. NDËRGJEGJËSIM MBI INFRASTRUKTURËN E CILËSISË, SARANDË

Fushata kombëtare mbi rolin dhe rëndësinë e metrologjisë në infrastrukturën e cilësisë, u zhvillua në qytetin e Sarandës në muajin Qershor 2023.

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit (DPS) zhvilluan një takim me studentë të universitetit, filiali Sarandë.

Përfaqësues të DPM-së prezantuan para studentëve dhe pedagogëve aspekte të përgjithshme të metrologjisë, shërbimet e verifikimit dhe kalibrimit si edhe rëndësinë e metrologjisë në mbrojtjen e konsumatorit. Pjesëmarrësve iu shpërndanë materiale të shumta edukuese dhe ndërgjegjësuese mbi rolin dhe rëndësinë e metrologjisë në jetën e përditshme.



9. AKTIVITETE PROMOVUESE

Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë mirëpriti në datë 09 Qeshor 2023 në ambientet e laboratorëve të Metrologjisë Shkencore dhe Industriale studentët e vitit të dytë të Masterit të Shkencave dhe Teknologjisë Ushqimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.



Në këtë vizitë studentët patën rastin të bashkëbisedojnë me stafin e laboratorëve të DPM-së duke u njohur kështu më nga afër me instrumentet matëse dhe procesin e punës që zhvillohet në secilin laborator.



10. DITA BOTËRORE E METROLOGJISË

Dita Botërore e Metrologjisë festohet çdo vit më 20 Maj, duke njohur kështu kontributin e të gjithë njerëzve që punojnë në organizatat dhe institutet ndërqeveritare dhe kombëtare të metrologjisë. Dita Botërore e Metrologjisë 2023 vjen me temë: "Matjet që mbështesin sistemin global të ushqimit". Kjo temë u zgjodh për sfidat në rritje të ndryshimeve klimatike dhe shpërndarjes globale të ushqimit, në një botë ku popullsia e së cilës arriti në 8 miliardë në fund të vitit 2022.

Dita Botërore e Metrologjisë **dpm**
Drejtoria Përgjithshme e Metrologjisë



Posterin e gjeni në faqen tonë të web-it:
<https://www.dpm.gov.al/dita-boterore-e-metrologjise-20-maj-2022-2/>

11. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË DHURON GJAK.

Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në bashkëpunim me personelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë ka realizuar në muajin Korrik seancën e dhurimit të gjakut në kuadër të fushatës kombëtare për dhurimin vullnetar të gjakut, në ndihmë të pacientëve me talasemi, të sëmurëve kronikë, hemofilikë dhe me dializë.

DPM do vazhdojë bashkëpunimin me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut pasi të dhurosh gjak është një akt solidariteti human dhe dhurata më e çmuar që mund ti bëjmë njerëzve që kanë nevojë për të.



12. MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI



Drejtorja e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FSHN) i Universitetit të Tiranës gjatë muajit Korrik 2023 kanë firmosur një marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje synon kordinimin dhe dëshirën e mirë të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin me qëllim ofrimin për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës praktika dhe trajnime sipas nevojave të tregut të punës.

Nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale studentët do të krijojnë mundësi për të marrë eksperiencë pune, do zhvillojnë dhe zgjerojnë dijet e fituara në fakultet si dhe do afirmohen dhe rritin mundësitë për punësim.

DPM sipas aktiviteteve respektive do të ketë mundësinë e njohjes dhe vlerësimit të studentëve për praktika pune në të ardhmen.

13. BROSHURA & POSTERA INFORMUES MBI VEPRIMTARINË E DPM-SË.



Drejtoria Përgjithshme e Metrologjisë

Kontakt:
 • metrology@dpm.gov.al
 • <https://www.facebook.com/dpmGovAL/>
 • <https://www.dpm.gov.al/>
 Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8

Laboratorët



Laboratori i masës



Laboratori i forcës dhe fortësisë



Laboratori i presionit



Laboratori i lagështirës



Laboratori i matjeve të temperaturës



Laboratori i volumave



Laboratori i gjatësisë



Laboratori i madhësive elektrike



Laboratori i matjeve kimike, Laboratori i analizave të alkoolit në frymëmarrje

Drejtoria e Metrologjisë Ligjore

Misioni i Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore është të mbrojë qytetarët nga matjet e pasakta nëpërmjet kontrollit metrologjik ligjor të instrumenteve matëse në fushat e transaksioneve ekonomike, mbrojtjen e ambientit, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë teknike.

Drejtoria e Metrologjisë Ligjore, në nivel kombëtar, është e organizuar në 4 Sektorë Shërbimi si vijon:

- Sektori i Shërbimeve nr.1, i cili ushtron aktivitetin e tij në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan.
- Sektori i Shërbimeve nr. 2, i cili ushtron aktivitetin e tij në qarqet Fier, Berat, Vlorë, Sarandë dhe Delvinë.
- Sektori i Shërbimeve nr. 3, i cili ushtron aktivitetin e tij në qarqet Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Dibër.
- Sektori i Shërbimeve nr. 4, i cili ushtron aktivitetin e tij në qarqet Korçë dhe Gjirokastrë.

Shërbimet metrologjike që ofron DML-ja:

- Njohje miratim tipi e Instrumentëve matëse ligjorisht të kontrolluara që importohen (përpara hapjes në treg dhe vënies në përdorim të tyre), që nuk janë objekt i markimit CE.
- Verifikim fillestar dhe periodik të instrumenteve matëse.
- Kontroll të subjekteve që prodhojnë, ambalazhojnë ose importojnë produkte të parapaktuara.

Kategoritë e instrumenteve matëse të cilat mbulojnë nga metrologjia ligjore:

- Peshore të llojeve dhe kapaciteteve të ndryshme
- Gramarë të llojeve dhe kapaciteteve të ndryshme klasa M1, M2, M3
- Peshore automobilistike
- Masa vëllimore të llojeve dhe përmasave të ndryshme vëllimore
- Kontalitra të shitjes me shumicë të karburantëve
- Taksimetra
- Manometra të paisjeve të fryrjes së gomave të automjeteve,
- Lloje të ndryshme produkte të ngurtë dhe të lëngët.

Instrumentet matëse që i nënshtrohen kontrollit metrologjik ligjor:

Në bazë të Ligjit Nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", instrumentet ligjorisht të kontrolluara janë ata instrumente që përdoren për:

- Transaksionet zyrtare dhe ekonomike, mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen e ambientit, rendin publik dhe sigurinë teknike.
- Kontrollin e produkteve të para-paktuara dhe shishave si enë matëse.

Kontakt:
 • metrology@dpm.gov.al
 • <https://www.facebook.com/dpmGovAL/>
 • <https://www.dpm.gov.al/>
 Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8



METROLOGJIA

Metrologjia është shkencë e matjeve dhe përbën një nga komponentët e infrastrukturës së cilësisë të nevojshme në çdo vend të zhvilluar pasi ka një ndikim të rëndësishëm tek standardet, rregulloret teknike dhe vlerësimi i konformitetit dhe luan rol themelor në mbrojtjen e konsumatorëve dhe ritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve.

Duke qenë shkencë e matjeve dhe e zbatimit të tyre, metrologjia përfshin tre fushat e njohura si metrologjia shkencore, metrologjia industriale dhe metrologjia ligjore.

Metrologjia shkencore merret me organizimin dhe zhvillimin e etaloneve (standardeve) të matjeve dhe mjekmbajtjen e tyre (niveli më i lartë)

Metrologjia industriale konsiston në zbatimin e shtetësisë së matjeve në industri, procesin e prodhimit dhe testimit për të siguruar funksionimin e përshtatshëm të instrumenteve të matjeve dhe cilësi në matjet e kryera

Metrologjia ligjore lidhet me aktivitetin që rregullon nga fushat e rreguluara për njësitë e matjeve, metodat dhe instrumentet e matjeve në transaksionet tregtare, mbrojtjen e konsumatorëve, mbrojtjen e shëndetit, sigurisë publike dhe mjedisit.

Sistemi kombëtar i metrologjisë në Republikën e Shqipërisë drejtohet dhe koordinohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe përfshin laboratorët e etaloneve kombëtare, laboratorët e kalibrimit, dhe personat juridikë të autorizuar për kryerjen e aktivitetit të metrologjisë ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, e specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në 4 sektorë shërbimi, në varësi të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe zhvillon aktivitetin e saj në mbështetje të ligjit Nr. 126, datë 15.10.2020 "Për metrologjinë", si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

DPM është institucion i specializuar që zotëron aftësi dhe ekspertizë e nevojshme për t'u përdorur si referencë për të gjitha transmetueshmëritë e matjeve në Shqipëri.

Kontakt: • metrology@dpm.gov.al • <https://www.facebook.com/dpmGovAL/> • <https://www.dpm.gov.al/>
 Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8



Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

MBROJTJA E KONSUMATORIT

Një ndër misionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është mbrojtja e konsumatorëve, nëpërmjet organizimit të kontrollit të instrumenteve matës në fushat e transaksioneve zyrtare dhe tregtare, mbrojtjes së shëndetit, mjedisit dhe sigurinë teknike, si dhe kontrolli sasior i parapaketimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë bashkëpunon ngushtësisht me Inspektoriatin Shtetëror të Mbrojtjes së Tregut në vendin tonë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe shoqatat/organizatat në mbrojtje të konsumatorëve. DPM periodikisht organizon fushata për ndërgjegjësimin e publikut.

Konsumatori është i lutur që të mos hyjë në marrëdhënie tregtie me tregtarë që përdorin instrumente matëse të pakontrolluara nga DPM, pra që nuk kanë të vendosur në vend të dukshëm shenjë e verifikimit ligjor. Ju lutemi, të denonconi pranë DPM-së të gjitha abuzimet që ndeshni në fushën e metrologjisë.

Kontakt:
 • metrology@dpm.gov.al
 • <https://www.facebook.com/dpmGovAL/>
 • <https://www.dpm.gov.al/>
 Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8




web: <https://www.dpm.gov.al/>
 e-mail: metrology@dpm.gov.al
 Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8

14. SUBJEKTET E AUTORIZUARA PËR KRYERJEN E VERIFIKIMEVE TË INSTRUMENTAVE MATËS LIGJËRISHT TË KONTROLLUAR

- “NOA CONTROL” SHPK, me nr. NIPT-i: L51622005C, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kati 2, Tiranë, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.2, datë 12.06.2023 “Për dhënien e autorizimit për verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, matësa uji”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 12.06.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 11.06.2027;
- “M&M Topuzi Group” SHPK, me nr. NIPT-i: L03306201H, me adresë: Metalurgji, Elbasan, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.3, datë 10.07.2023 “Për dhënien e autorizimit për riparim, verifikim dhe vulosje të përkohshëm të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, peshore automobilistike NAWI, klasa III dhe IV, me kapacitet maksimal deri në 50T”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 19.07.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 18.07.2027;
- “3G” SHPK, me nr. NIPT-i: L27313002C, me adresë: Sheshi “2 Prilli”, pas Rektoratit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.4, datë 17.07.2023 “Për një ndryshim në vendimin administrativ Nr.6, datë 28.12.2021 “Për dhënien e autorizimit për verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, matës të energjisë elektrike. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 17.07.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 01.04.2026;
- “AL-INSPEKTIM” SHPK, me nr. NIPT-i: L52402504M, me adresë: Pjezë, Xhafzotaj, Durrës, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.5, datë 19.07.2023 “Për një ndryshim në vendimin administrativ Nr.3, datë 07.09.2021 “Për dhënien e autorizimit për verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, autobote (cisterna rrugore). Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 19.07.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 16.09.2025.
- “TUNAMAR” SHPK, me nr. NIPT-i: L42610208C, me adresë: Njësia Administrative Bradashesh, fshati Kusarth, Rruga “Kadri Hoxha”, Elbasan, autorizuar sipas Vendimit Administrativ Nr.6, datë 17.08.2023 “Për riparim, verifikim dhe vulosje të përkohshme të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, instrumente të peshimit joautomatik (NAWI)”. Data e hyrjes në fuqi të vendimit është 01.09.2023, ndërsa vlefshmëria e tij është deri në datën 31.08.2027.

KËSHILLI BOTUES



Drejtoria Pergjithshme e Metrologjise

Kontakt:



metrology@dpm.gov.al



<https://www.dpm.gov.al/>



<https://www.facebook.com/dpmGovAL/>



Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km.8, Kashar, Tiranë, Shqipëri

